REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 87 *prot.*

Kamëz, më 21.9 *.2026*

V E N D I M

Nr 72 **Datë** 21/9 **/2026**

"PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR 90 DATË 17.12.2025, 'PËR MIRATIMIN E DETAJIMIT TË BUXHETIT PËR VITET 2026, 2027, 2028' "

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt. 21.09.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt- Vendimin nr.59 datë 14.09.2026, Në mbështetje të:

- *Ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 34, 40, 41, 54, 55,*
- *Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 "Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar,*
- *Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010 , "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin ..*
- *Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017"Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"*
- *Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore " I ndryshuar*
- *Udhëzimin Nr. 8 datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2026-2028 "*
- *Udhëzimin Plotesues Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ", i ndryshuar*
- *Udhëzimin Plotesues Nr. 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2025",*

V E N D O S I

Në V.K.B nr 90 datë 17.12.2025 "për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2026, 2027, 2028", të bëhen ndryshimet si më poshte:

1. Miratimin e ndryshimeve në tabelën e shpenzimeve për funksionim për vitin 2026, sipas paqyrës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e ndryshimeve në tabelën e Investimeve per vitin 2026, sipas paqyrës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e tij.
3. Miratimin e struktures buxhetore për vitin 2026 (për ndryshimet) sipas pasqyrës bashkëlidhur.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut.

KRYETARI KESHILLIT

HYSEN KOLDASHI